



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

**P.nr.631/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm,** Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. H. nga fsh.H.q K.Gj., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP/II.nr.1366/2017 të datës 28.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **08.10.2018**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të akuzuarit, të Përfaqësuesit të autorizuar të K.-D.në Gj., në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **D.H.**, nga i ati M. dhe e ëma Gj. e gjinisë C., data e lindjes...në fsh.H. K.Gj., ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, atë 4 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike-realizues i ndihmave sociale, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës.

**Ë s h t ë f a j t o r:**

**Sepse:** Nga data e pavërtetuar e gjer me dt.28.03.2017 në shtëpinë e tij në fshatin H.komuna Gj. , me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K.-it, është konstatuar se i pandehuri pa njehsor elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar K.-divizioni në Gj. i ka shkaktuar dëme në shumën 212.48 euro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1, 41, 46, 49, 50, 51, 52 par.5, 73, dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton;

**DËNIM ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

E dëmtuara K.- D. në Gj. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1366/2017, të datës 28.09.2017, kundër të akuzuarit D.H. nga fsh.H. K.Gj. , për shkak të veprës penale, shfrytëzimi i paaautorizuar i energjisë elektrike, nga neni 61 parg.1 pika 1.2 të Ligjit për Energji elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala pasi lexoi aktakuzën bënë rikualifikimin e veprës penale,nga vepra penale, shfrytëzim i paaautorizuar i energjisë elektrike, nga neni 61 par.1 pika 1.2 të Ligjit për energjinë elektrike të R.së Kosovës, nr.05/L-85, në veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari D.H. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron se e pranon fajësinë ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë, duke premtuar se të njëjtën nuk do ta përsëris, është e vërtetë që nuk kam pas njehsor elektrik por K. nuk ma ka sjellë me kohë njehsorin edhe pse disa herë kam bërë kërkesë, prandaj jam detyruar që direkt përmes kabllos të lidhem në rrjetin elektrik pasi që familja ime nuk ka pasur rrym, por tani kam njehsorin elektrik dhe jam pagues i rregullt i shpenzimeve të energjisë elektrike, shton se jam në gjendje të varfër materiale, jam realizues i ndihmave sociale, jam mbajtës i vetëm i familjes, për herë të parë ndeshem me ligjin, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysht këto rrethana me rastin e shqiptimit të dënimit.

E dëmtuara përfaqësuesi i autorizuar i K.-D.në Gj., L. M. deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, unë si përfaqësues i të dëmtuarës i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe kërkoi kompensimin e dëmit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari D.H.: Nga data e pavërtetuar e gjer me dt.28.03.2017 në shtëpinë e tij në fshatin H. komuna Gj. , me qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K. -it, është konstatuar se i pandehuri pa njehsor elektrik përmes kabllos është lidhur direkt në rrjetin elektrik duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar K.-divizioni në G. i ka shkaktuar dëme në shumën 212.48 euro.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i 4 fëmijëve, gjendjen e tij të varfër ekonomike, është realizues i ndihmave sociale, pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë veprë penale, e sidomos faktin se për herë të parë ndeshet me ligjin, Gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(njëqind) Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.631/17 me datën 08.10.2018**

**Procesmbajtësja,**  
**Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Diana Sina**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:030525  
Datë: 08.10.2018  
Numri i dokumentit: 00148122